



Prishtine, 23.04.2019

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) – Në pajtim me nenin 59, paragrafi 1 dhe nenit 62, paragrafi 6 të Ligjit Nr. 03/L – 163 për Miniera dhe Minerale , Bordi i KPMM-së në mbledhjen e mbajtur me datën 19.04.2019 mori këtë;

### V E N D I M P E R R A S T E T E R I A P L I K I M I T

**I.** Ndërmarrjet të cilat kanë aplikuar në KPMM për Licencë Hulumtimi Shfrytëzimi apo Leje për Aktivitete të Veçanta dhe cilave iu është aprovuar nga Bordi i KPMM-se mirëpo për shkaqe të ndryshme nuk kanë arritur që brenda afatit të caktuar të plotësojnë kushte e parashtruara me Aktvendim nga Bordi, iu mundësohet **ri aplikimi vetëm pas kryerjes se pagesës 2000 euro taksë për ri aplikim.**

**II.** Nëse kërkesat për ri aplikim bëhen para afatit të skadimit të vlefshmërisë së dokumentacionit të dorëzuar nga ndërmarrjet në KPMM, atëherë ndërmarrja nuk ka nevojë të sjell dokumentacion të ri, dhe pas kryerjes së pagesës dhe përmbushjes së kushteve Ligjore të Licencës/Lejes, lejohet tërheqja e tyre.

**III.** Ky Vendim vlen për të gjitha ato aplikacione të cilat kanë aplikuar në KPMM dhe ju ka aprovuar kërkesat për Licencë apo Leje nga Bordi i KPMM-se, mirëpo kanë dështuar në përmbushjen e kushteve të përcaktuara me Ligjin Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale dhe Ligjin Nr. 04/L-158 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-163.

### A R S Y E T I M I

Bordi i KPMM-së në mbledhjen e mbajtur me datë 19.04.2019, duke u bazuar në autorizimet e nenit 62 paragrafi 6 mori këtë vendim me qëllim të rregullimit të licencimit, dhe respektimin e LMM-se. Arsyetimi bazohet në pikën 1.6 të nenit 6 të LMM-se. Me rastin e aplikimit kompania përveç tjerash dorëzon edhe deklaratën me të cilën deklaron që i përmbush të gjitha obligimet e parapara me ligj që nder të tjera përfshihet edhe pika 1.4.1, 1.4.2 të nenit 6, pikën 1.11 të nenit 31 dhe 1.11 të nenit 38 të Ligjit për Miniera dhe Minerale. Në rast të aprovimit të kërkesës për licence apo leje, aplikuesi përveç tjerash duhet të plotësojë pikat me lartë, në rast të dështimit atëherë në baze të pikës 1.6. të nenit 6 të LMM-se KPMM mund të konstatoj se kompania me rastin e aplikimit të parë ka paraqitur fakte materialisht të rrejshme në kërkesën e tij.

Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Bordit me numër reference Nr. 33/2017 i datës 15.08.2017.

Musa Shabani  
Kryesues i Bordit të KPMM-se